

Η αεροστάτης σφαίρα (Balona)

Poemë satirike nga Dr. Ioanis Vilaras *

Pa mblidhuni o njerëz e shumë mos vononi,
ju pleq edhe të vegjël, rini edhe madhóri,
të varfër e të pasur, civilë e lëvdarë,
robërë të vojtur, o- edhe ju të çalë.
Shpejt u them vrapohi, në s mundi un's'kam fajë,
ejani të gjithë vraponi pa u ndalë,
ajdeni nga jeni askush të mosë mbesë,
s'ajo që do ndodhë s'është par'për besë.
Ejani të shihni francezinë Ikarë,
të famshminë e ndritur, Jean Pierre Blanchard,
dili që të shihni Wolfunierinë bëmak,
gëzoju o i madh, zelltar dijetar Shirák.
E gjithë lavdia e jotja është.

*

Ikarusi i Ri kërkon të flutërojë,
u mbluadhë me vrap atë që ta takojnë,
ja edhe Pahómi që do që t'a ndihmojë,
mbi sup-e ngriti majtas ashtu që të anojë.
Nga krahu i djathtë doli me Gjergjinë Kurtë,
dhe Nikolla Jágoja me gunënë e shkurtë,

ja edhe Dhimitri tre hapa zu nga prapa,
po rri kallam i ngrirë aty për nga përzhdrapa.
Ja dhe Gjergji Arti që doli për matanë,
Kondojanjói u nxi me katranë,
mbi kokë se ç'e derdhi qymyrin me mangallë,
dhjetë vllëh' të tjerë seç nxori në mëhallë.
-Oh medet medeti!.

Të gjithë kanë sjellë me vete ca farashë,
kazma, cung, lopata, e ca litar të trashë
çapinj, pirunj-e cfurqe, dërrasa e drepanë,
thasët me zhavor sqeparët zift-katramë.
Bërtasinë e shkojnë, vinjënë vërdallë,
fëmijëtë me turma rrethojnë anembanë,
drejt-e te prroji kërcenjënë me bark,
Sferënë të ngrejnë lundrimin që nga lart.
Harbojnë ndënë drunj të shohinë Ballonë,
me gas t'a vëshëlajnë të shkretinë Pahómë.

U mblodhënë të gjithë e zunë që ta qeshin'
të gjojnë Pahómë që bëri përsheshin,
vrapin Kondoiani të largoj mangallë,
Ballona që u shpua si do vejë ky hallë ?!
E nxuarë nga koshi të shkretinë Pahómë,
me kapënë prej leshi veshur në Ballonë,

I pari qe ky Gjergji ay që dhe e nxori,
Arti dhe mbiemrin atija seç i'a thonë.
I gjori ky Pahómi po prapë s'bëri prapa,
sërisht zu t'i fryjë po aq edhe nga mbrapa,
po prapë fat nuk pati të ngrihetë në erë,
kjo qerrja e shkretuar që na i thënkshin Sferë.
Erdhën Gjergji Arti e Dhimoja Koleci,
pas traut që të lidhin koshin që të ngeci,
e hapënë pëlhurën të dy porsi të çmendur
ta frynjënë filluan -ah!, sa shumë të mençur!.
Ja dhe ku na erdhë e dhjetë vllëh' të tjerë,
ndihmë Kurt, Kolecit, Pahómitë të mjerë,
Ballonën që ta fryjnë e nisënë gjith' tok,
me mundinë e humbur prej kohe që më kot.
Kurti thotë: Pre-domnexeo! *
-e nëse kjo s'fryhet, ç'faj kam un' oe-o ?!,
kaq përpjekje bëra do fryja nj'mij' gomerë.
Nuk s'kuqetë s'djersitet Éfesti ciklop
peshën ul mbi kudhër ky i madhi Z o t
Dhéunë e tund aty që ku godet
Etna hedh jehonën qametin që thërret.

E-seç ay që zuri filloj të dërdëllasë,
xhindoja Pahómi kaq shumë të bërtasë,
tu-trazuar zjarrin bublákun djegarak,

kuqalashin prush të ndezurin përflak'.
Kondójanit i thrret t'i sjellinë mangallë,
squfuri katran vrapoi me gërdallë,
ja dhe më në fund u fry aq sa dhe vatë,
një-dit-e gjysm-natë, Ballónë moj e prapë.
E-u ngrit kjo flaka në Kupë mu si shpatë,
zunë u tërbuan të shkretët vllëh argátë,
e-gjithë mu sa qenë aty edhe tek ferret
kërcyen-hopin, hop! , e-mu në kosh menderet.

Që të gjithë hynë në Sferë!

E-kur zu të rrokulliset,
kjo anija vërdalliset,
në të thellin det të egër,
çahet, shqyhet e gremiset.
Po bërtet Pahóm-i gjorë,
ballonshkreta po shkërmoqet,
edhe gunën e çobanit,
e shtrëngon kaq fort tek roqet.
-Oh sa keq do të na lejë,
-thot' Pahómi, -në djall të vejë!.
Sado që të vrapojnë nxitimthi që ta mbajnë,
përmbysëtë Balona me lotë ata qajnë,
tundenë e shkunden e hidhenë bërtasin,

ju vlllehë o të mjerë bretkosat po kuasin.

E-ç'farë mund të presësh nga njerëzë të tillë?

ju-lai s'ardi *-mëkatetë me brirë,

Balona që u cof çoban akoma mbete,

o zotëni Pahómë ustanë se ç'e gjete.

Se po të qe që kishe ca mendje dhe të tjera,

turpinë e shkretë s'do kishe mu te dera,

ndaj ikë të nxitosh s'të mbeti asgjë tjetër,

të mbledhëshë të tutë nën gunënë e vjetër.

U ndeze shkrumb o Sferë u dogje dhe me hi....,

qiri u tret jehona që humbi me magji,

lëshoji Agu ditën, e zuri me flori,

pordhësë ç'ia dha, nusja fi-ri-fi.

Martesa ç'na dështoi e dimë un' dhe ti

e di dhe Papakami i gjithë fshati rri.

(shqipëroi Aleksandër Vasili)